



Funded by  
the European Union



---

## Arsimi i lartë nën hijen e korrupsionit

**Klea Vujoshi**

Studente, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Szkodrës “Luigj Gurakuqi”

**Shtator 2024**

*Ky artikull u realizua në kuadër të projektit “Studentët e Drejtësisë në Frontin kundër Korrupsionit!”, që është pjesë e mekanizmit të skemave të nëngranteve të projektit ‘Mbështesim Pjesëmarrjen, Përgjeshmërinë dhe Fuqizimin e Shoqërisë Civile’(SPACE), financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga shoqata Together for Life, në bashkëpunim me BIRN Albania, Qëndresa Qytetare dhe DCE”. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e autorit dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e Bashkimit Evropian, apo organizatave zbatuese.*



Fenomeni i korrupsionit është një ndër më shqetësuesit të shoqërisë mbarë globale. Duke shfrytëzuar terrenin e një shoqërie të ashtuquajtur “demokratike”, ky virus e zhyt shoqërinë duke mos e lejuar të kapërceje në trampolinat e zhvillimit human e demokratik. Përkufizimi më gjerësisht i pranuar i korrupsionit është si “abuzim me detyrën për përfitime personale”. Veçanërisht ky fenomen në një vend i cili është akoma në tranzicion, krahas pengesave në zhvillimin ekonomik e politik, po ndikon në mos-zhvillimin e emancipimit social.

Korrupsioni në universitete ka kosto sociale dhe politike. Ai mund të zvogëlojë prestigjin e arsimit të lartë kombëtar, të ulë aftësinë për të negociuar për diploma të përbashkëta dhe transferimin e krediteve me vendet e tjera, si dhe të limitojë aftësinë për të përthithur punonjës të rinj. Punësimi i të afërmeve, miqve dhe të njohurve përmes favorizimit dhe rryshfeteve është një ndër praktikatat më të zakonshme dhe më të hasura të korrupsionit në vendin tonë. Kështu, pozicione dhe detyra të krijuara artificialisht kanë krijuar një ngërç në zgjidhjen e problemit.<sup>1</sup>

Lufta ndaj korrupsionit në universitete është e vështirë sepse ky akt kryhet nga njerëz inteligjentë dhe të veshur me pushtet dhe kërkon një bashkërendim të punës së të gjithë institucioneve dhe organizmave që punojnë dhe kanë ndikim në parandalimin e këtij fenomeni negativ për sistemin arsimor dhe gjithë shoqërinë shqiptare. Një numër i rasteve të mundshme korruptive lidhen me masat qeveritare dhe ndërhyrjen e saj në ekonomi, të cilat janë të përcaktuara nga politikat qeveritare. Arsyeja kryesore që ky fenomen ka ekzistuar dhe është akoma i pranishëm në shoqëri është se shkaqet që çojnë në zhvillimin e këtij fenomeni nuk kanë arritur të eliminohen tërësisht, pavarësisht zhvillimeve që kanë ndodhur me kalimin e kohës. Sipas të gjitha studimeve të fundit kombëtare dhe ndërkombëtare perceptimi i korrupsionit në Shqipëri është relativisht i lartë dhe korrupsioni shihet si një pengesë e madhe në zhvillimin e vendit.<sup>2</sup>

Sipas një raporti të bërë nga një organizatë lidhur me një pyetësor online u shpërnda në të gjithë fakultetet dhe universitetet e Shqipërisë, në vlerësimin e studentëve, 90 % e tyre mendojnë se korrupsioni në universitetet publike është mbi nivelin mesatar ndërsa 70 % e tyre janë përgjigjur se fenomeni i korrupsionit është i pranishëm në programin e tyre të studimit. Sa i përket formave të shfaqjes së korrupsionit, sipas 200 studentëve nga 248 të anketuar, forma më e përhapur e shfaqjes së korrupsionit është ajo e pagesës në këmbim të notës, e ndjekur nga detyrimi për blerjen e librave<sup>3</sup>

Niveli i denoncimit të rasteve është mjaft i ulët, vetëm 10% dhe nga këto 40 % përgjigjen se ka munguar ndëshkueshmëria nga organet kompetente. Nëse studentët do të binin në kontakt me një rast korruptiv, vetëm 40% e tyre do të denoncin ndërsa pjesa tjetër do të refuzonte të bënte një denoncim. Kjo për shkak të treguesit tjetër të besueshmërisë tek adresimi i drejtë i rasteve korruptive, ku 60 % e studentëve nuk besojnë se denoncimet do të jenë efektive në zgjidhjen e problemit;<sup>4</sup>

Prania e fenomenit të korrupsionit në arsimin e lartë, përveçse përbën një vepër penale të dënueshme sipas kodit penal, ka dekurajuar në masë studentët të cilët mendojnë se ka efekte

<sup>1</sup> Stephen P. Heyneman, The Concern with Corruption in Higher Education

<sup>2</sup> Sondazh “Korrupsioni në arsimin e lartë” 2009

<sup>3</sup> Raport mbi Korrupsionin në Arsimin e Lartë, Korrik 2017, Qëndresa Qytetare

<sup>4</sup> Po aty



demotivuese për të studiuar, krijon pabarazi në vlerësimin e tyre dhe pabarazi në tregun e punës;<sup>5</sup>

Shqipëria gjatë viteve ka ratifikuar instrumente ndërkombëtare të rëndësishme në luftën kundër korrupsionit si, Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventën e të Drejtës Civile dhe Penale të Këshillit të Evropës për Korrupsionin, Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy Protokollat e saj shtesë, Marrëveshjen midis Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (EUROPOL) për Bashkëpunim Strategjik dhe Operacional. Kuadri ligjor i brendshëm kundër korrupsionit përmban një seri aktesh që nisin që me Kushtetutën, ligjet (kodet) dhe ligjet (kodet) procedurale, ligjet e organizimit dhe funksionimit të institucioneve si dhe kuadrin rregullator të instrumenteve kundër korrupsionit. Më konkretisht, legjislati shqiptar parashikon detyrime ligjore për institucionet publike në drejtim të transparencës së punës së administratës publike, parandalimit të konfliktit të interesit, kontrollit mbi deklarin e pasurisë së zyrtarëve publikë, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesëve, dhe etikën në qeverisje. Pavarësisht arritjeve, ka ende një sërë problematikash në drejtim të efektivitetit të luftës kundër korrupsionit.<sup>6</sup>

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Mungesa e transparencës nga ana e institucioneve të arsimit të lartë apo qeverisë, dhe shumë shkaqe të tjera të cilat sigurojnë vazhdimin e këtij fenomeni. Hapi i parë për krijimin një shoqërie të shëndetshme është rritja e shkallës së ndërgjegjësimit kolektiv mbi shkaqet si dhe pasojat e korrupsionit në shoqëri. Gjithashtu, është e paevitueshme ndihma e qeverisë në ndikimin e uljes së nivelit të korrupsionit, kjo duke rritur transparencën me qytetarët, ndëshkimin me ligj të iniciatorëve të korrupsionit, arritjen e një stabiliteti ekonomik. Pra, hallka kryesore për reduktimin e këtij fenomeni është zbatueshmëria me përpikëri e legjislatit nga ana e gjithsecilit.<sup>7</sup>

Besoj që unë dhe të tjerë të rinj si unë, jemi ata që duhet të valëvitim flamurin e kësaj qasje të re. Është disi e vështirë të propozoj zgjidhje konkrete në nivel strategjik për një rritje të efikasitetit të luftës ndaj korrupsionit në fusha të ndryshme, por besoj që këtë ndryshim duhet ta fillojmë nga vetja. Gjithsekush duhet të reflektojë dhe me veprimet e tij konkrete të refuzojë dhe të përbuzë pa mëdyshje dhe me forcë çdo praktikë korruptive. Dhe në rastet kur dikush ka dijeni për praktika të tilla, zgjidhja më e mirë padyshim do të ishte denoncimi në organet kompetente. Nevojiten jo lot e ngashërime kolektive për gjendjen aktuale dhe moralizma, por akte dhe veprime konkrete. Unë besoj te forca e shembullit, këtë bindje e bazoj dhe në përfshirjen time në Qeverinë Studentore ku dhe përfaqësoj degën e drejtësisë e cila lidhet ngushtësisht me temën e korrupsionit. Shoqëria që promovon vlerat e drejtësisë dhe iniciativave të lira të njerëzve dhe pse jo... shoqëria që punon e gjitha si një trup i vetëm për një ekonomi e të ardhme më të mirë është shoqëria që unë dua. Kjo është arsyeja pse unë si e re, i them dhe gjithmonë do t'i them JO KORRUPSIONIT!

<sup>5</sup> INSTAT 2014

<sup>6</sup> Open Data Albania, Projektbuxheti 2015

<sup>7</sup> B. Michael, Konceptet ligjore bazë të anti-korrupsionit: Përcaktimi i juridiksionit, zgjedhjet civile dhe dëshmipërblimet- Rasti i Shqipërisë, 2008



Funded by  
the European Union



---

## **BIBLOGRAFIA**

1. INSTAT, 2014 ;
2. Sondazh "Korrupsioni në arsimin e lartë" 2009 ;
3. Raport mbi Korrupsionin në Arsimin e Lartë, Korrik 2017, Qëndresa Qytetare
4. Bryan Michael, Konceptet ligjore bazë të anti-korrupsionit: Përcaktimi i juridiksionit, zgjedhjet civile dhe dëmshpërblimet- Rasti i Shqipërisë, 2008 ;
5. Open Data Albania, Projektbuxheti 2015 ;